


REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA-MAYOR'S OFFICE-BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 40 dhe 41 të Rregullores nr. 02/2010 për Procedurat e rekrutimit të Shërbyesve Civilë lidhur me nenin 4 paragrafi 2 të Rregullores nr.07/2010 për emërimin e nëpunësve civilë Kryetari i Komunës, në cilësinë e Udhëheqësit më të lartë administrativ dhe punëdhënës, pas shqyrtimit të Raportit final të rekomandimit nga Komisioni përzgjedhës ad hoc i shërbyesve civilë të datës 01.08.2016 nxjerrë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E RAPORTIT FINAL TË REKOMANDIMIT TË KOMISIONIT
PËRZGJEDHËS TË SHËRBYESVE CIVIL

1. Aprovohet raporti final i rekomandimit të Komisioni Përzgjedhës të Shërbyesve Civil sipas konkursit të shpallur më datë, **05 tetor 2016** në të përditshmën e pavarur informative "Kosova Sot", web faqen dhe tabelen e shpalljeve komunale për plotësimin e pozitave të lira punuese: Përfaqësues ligjor i Komunës, Zyrtar për bujqësi, Zyrtar për procedimin e të dhënave, Inspektor i tregut, andaj Përzgjedhen dhe emërohen kandidatët më të suksesshëm sipas pikëve të fituara në testimin me shkrim dhe me gojë si në vijim:

1.1 Përfaqësues ligjor i Komunës, nr. i ref. JP00019221

Arben Mehmeti..... **90.1 pikë**

1.2 Zyrtar për bujqësi, nr. i ref. JP00019219

Ejup Byqmeti..... **89.8 pikë**

1.3 Zyrtar për procedimin e të dhënave, nr. i ref. JP00019220

Afërdita Pira **89.5 pikë**

1.4 Inspektor i tregut, nr. i ref. JP00019221

Afërdita Fetahu..... **89.5 pikë**

2. Akti zyrtar i emërimit të kandidatëve të përzgjedhur dhe emëruar do të lëshohet brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e nënshkrimit, protokollimit dhe publikimit të këtij vendimi, ku të njëjtit do të njoftohen me shkrim me çka edhe përfundon procedura e rekrutimit.

3. Autorizohet njësia e personelit që të publikojë vendimin mbi rezultatet e procedurës së rekrutimit në tabelen komunale të publikimeve dhe në web faqen e komunës.

4. Vendimi hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit dhe protokollimit.

Këshilla juridike: Kandidatët e pakënaqur me mos përzgjedhje dhe emërim në pozitën përkatëse mund të parashtrojnë ankesë, Komisionit Komunal për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave në afatin prej **30** ditësh nga dita e shpalljes së këtij vendimi.



Kryetari i Komunës

Lutfi Haziri